




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0021659-3/25 dt. 28.04.2025

Mitrovicë

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenin 14, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/15, qershor 2008); nenin 21, të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 10/03 Prill 2019); nenin 24, paragrafët 1, 2 dhe 6.3, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për procedurat e dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale; nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 dhe nenin 15, paragrafi 2, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 29.04.2020; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 28.04.2025, pasi shqyrtoi Propozim-vendimin Nr. 02-463/06-0022252/25 dt. 16.04.2025 Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës "Diakonie Kosova", pa procedura konkurrimi, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0021658-3/25 dt. 25.04.2025); sjell këtë:

VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale "Diakonie Kosova" pa procedura konkurrimi

1. MIRATOHET Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale parcelës "Diakonie Kosova" pa procedura konkurrimi.
2. Prona e Paluajtshme Komunale e dhënë në shfrytëzim sipas pikës 1 të këtij Vendimi është Parcela kadastrale P-71208017-0582-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 74560 m², e cila gjendet në vendin e quajtur "Frashër i Vogël", Zona Kadastrale Vaganicë, Pronë e Komunës së Mitrovicës së Jugut.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale është mbështetja e iniciativës së "Diakonie Kosova" në zgjerimin e një investimi të një "ferme" e cila do të kontribuoj edhe në integrimin e tregut të punës dhe që nuk cenon rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin dhe që nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.
4. Shfrytëzimi i pronës do të jetë në kohëzgjatje për 10 (dhjetë) vite dhe ky shfrytëzim do të jetë pa kompensim - qira.
5. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për Rastë të veçanta, evidentohet në regjistrin e të drejtave pronësore.
6. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm.
8. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
- 1 x 1 MAPL
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës
DGJKP dhe DPU

